

20232624550

## СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

### L I G J

#### **I HUAMARRJES SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ME HUA NË BANKËN EUROPIANE TË INVESTIMEVE SIPAS MARRËVESHJES FINANCIARE PËR KORRIDORIN HEKURUDHOR VIII – SEGMENTI LINDOR MQ, SEGMENTI KRIVA PALLANKË – KUFIRI NDËRMJET MAQEDONISË SË VERIUT DHE BULLGARISË**

##### Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut merr hua nga Banka Europiane e Investimeve në vlerë prej 175.000.000 eurove, e destinuar për financimin e projektit - Korridori hekurudhor VIII – segmenti lindor MQ, segmenti Kriva Pallankë - kufiri ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë, që pjesërisht financohet edhe përmes Instrumentit të Ndhmës Paraaderuese – IPA të Bashkimit Europian.

##### Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit, të huas së nenit 1 të këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen financiare për Korridorin hekurudhor VIII – segmenti lindor MQ, segmenti Kriva Pallankë - kufiri ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë, e cila do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Europiane të Investimeve.

Marrëveshjen financiare të paragrafit (1) të këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

##### Neni 3

Huaja e cekur në nenin 1 të këtij ligji, tërhiqet msegmentimum në 12 transhe. Vlera minimale e një transheje është 5.000.000 euro.

Norma e interesit do të përcaktohet veçmas për çdo transhe të huas, në ditën e parashtrimit të kërkesës për tërheqjen e mjeteve të huas nga ana e Ministrisë së Financave, në varësi të normës së interesit që është më e favorshme për Republikën e Maqedonisë së Veriut (fikse ose variabile).

Afati i shlyerjes së çdo transheje të huas mund të jetë së paku 4 vjet deri në msegmentimum 25 vjet nga dita e tërheqjes së transhesë, me periudhë grejs të përfshirë, e cila mund të jetë prej 30 ditëve deri në 5 vjet nga dita e tërheqjes së transhesë.

Afati i shlyerjes së huas do të përcaktohet veçmas për çdo transhe, në ditën e parashtrimit të kërkesës për tërheqjen e mjeteve të huas nga Ministria e Financave.

Transheja mund të paguhet edhe në mënyrë të njehershme në afat nga 3 vjet deri në 15 vjet nga dita e tërheqjes së transhesë.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Europiane të Investimeve provizion të njehershëm në vlerë prej 50.000 eurove.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Europiane të Investimeve provizion për mjetet e patërhequra në vlerë prej 0.10% të huas në nivel vjetor.

Provizioni për mjetet e patërhequra të transhesë së parë do të fillojë të përllogaritet pas 48 muajve nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes financiare të cekur në nenin 2 të këtij ligji.

##### Neni 4

Projektin e cekur në nenin 1 të këtij ligji, do ta zbatojnë Ministria e Financave – Sektori i Financimit Qendror dhe Lidhjes së Marrëveshjeve dhe Ndërmarrja Publike e Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut” - Shkup.

#### Neni 5

Për realizimin e projektit të cekur në nenin 1 të këtij ligji, Ndërmarrja Publike e Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut” - Shkup do ta nënshkruajë Marrëveshjen për implementimin e projektit me Bankën Europiane të Investimeve.

#### Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella që rezultojnë nga Marrëveshja financiare e cekur në nenin 2 të këtij ligji dhe Marrëveshja e implimentimit të projektit e cekur në nenin 5 të këtij ligji, Ministria e Financave, Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve dhe Ndërmarrja Publike e Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut” - Shkup do të nënshkruajnë marrëveshje të posaçme.

#### Neni 7

Huan e cekur në nenin 1 të këtij ligji, Republika e Maqedonisë së Veriut do ta shlyejë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### Neni 8

Qarkullimi i të mirave dhe/ose shërbimeve të realizuara nga realizuesi i përzgjedhur ndaj Ndërmarrjes Publike të Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut” – Shkup, të destinuara për realizimin e Projektit - Korridori hekurudhor VIII – segmenti lindor MQ, segmenti Kriva Pallankë - kufiri ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë, të financuar me Marrëveshjen financiare sipas nenit 2 të këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar me të drejtën e zbritjes së tatimit paraprak.

Për qarkullimin e të mirave dhe/ose shërbimeve të realizuara nga realizuesi i përzgjedhur ndaj Ndërmarrjes Publike të Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut” - Shkup, të destinuara për realizimin e projektit - Korridori hekurudhor VIII – segmenti lindor MQ, segmenti Kriva Pallankë - kufiri ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë, të financuar me Marrëveshjen financiare sipas nenit 2 të këtij ligji, për të cilën Ndërmarrja Publike e Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut” - Shkup është debitore tatimore, në përputhje me nenin 32 pika 4) e Ligjit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, ndërmarrja lirohet nga detyrimi për përlllogaritjen dhe pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar.

Për qarkullimin e realizuar të të mirave dhe/ose shërbimeve dhe të liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, sipas paragrafit (1) të këtij neni, realizuesi i qarkullimit në faturë thekson se “tatimi mbi vlerën e shtuar nuk është përlllogaritur”, me ç’rast thekson bazën e lirimit nga tatimi mbi vlerën e shtuar, përkatësisht, titullin e projektit dhe titullin e Marrëveshjes financiare të nenit 2 të këtij ligji.

Importi i realizuar i të mirave/mallrave nga Ndërmarrja Publike e Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut” Shkup, të destinuara për realizimin e Projektit - Korridori hekurudhor VIII – segmenti lindor MQ, segmenti Kriva Pallankë - kufiri ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë, të financuar nga Marrëveshja financiare, sipas nenit 2 të këtij ligji është liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, detyrimet e importit, akciza e energjensave dhe tatimi i mjeteve motorike gjatë kohëzgjatjes së projektit në fjalë.

Ndërmarrja Publike e Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut” - Shkup gjatë importit të të mirave/mallrave të liruara sipas paragrafit (4) të këtij neni, organit kompetent doganor duhet t’i dorëzojë detyrimisht kopje të Marrëveshjes financiare sipas nenit 2 të këtij ligji, si dhe deklaratë se të mirat/mallrat e importuara janë të destinuara për realizimin e Projektit - Korridori hekurudhor VIII – segmenti lindor MQ, segmenti Kriva Pallankë - kufiri ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë, të financuar nga Marrëveshja financiare sipas nenit 2 të këtij ligji.

Sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, qarkullimi i të mirave dhe/ose shërbimeve, si dhe importi i të mirave/mallrave sipas paragrafit (4) të këtij neni, nuk mund ta tejkalojë vlerën e huas së nenit 1 të këtij ligji.

#### Neni 9

Të mirat/mallrat që lirohen nga pagesa e detyrimeve të importit në bazë të nenit 8 paragrafi (4) të këtij ligji, në afat prej 3 vjetësh nga dita e importit nuk mund të tjetërsohen, t'i jepen për shfrytëzim ndonjë personi tjetër, të huazohen ose të shfrytëzohen në ndonjë mënyrë tjetër për qëllime të tjera dhe jo për ato për të cilat janë liruar nga pagesa e detyrimeve të importit, para se të paguhen detyrimet e importit. Të mirat/mallrat nuk mund të jepen si kolateral, të huazohen ose të jepen si sigurim për detyrimet e tjera.

Nëse poseduesi i së drejtës, para përfundimit të afatit sipas paragrafit (1) të këtij neni, të mirat/mallrat e liruar nga pagesa e detyrimeve të importit në bazë të nenit 8 paragrafi (4) të këtij ligji, ka për qëllim t'i shfrytëzojë për qëllime të tjera, e jo për ato për të cilat janë të liruar nga pagesa e detyrimeve të importit, parashton kërkesë për pagesën e borxhit doganor në organin doganor.

Vlerën e borxhit doganor sipas paragrafit (2) të këtij neni, organi doganor e përlllogarit në bazë të elementëve për përcaktimin e detyrimeve që janë të vlefshme gjatë parashtrimit të kërkesës për pagesën e borxhit doganor.

Në rast të mosrespektimit të dispozitave sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, vlera e borxhit doganor përlllogaritet në bazë të elementëve të përcaktimit të detyrimeve gjatë pranimi të deklaratës doganore, në bazë të së cilës mallrat lirohen nga pagesa e detyrimeve të importit.

#### Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.